



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 08 prot.

Kamëz, më 23.01 2023

V E N D I M
Nr 08 .Datë 23.01 2023
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË PROGRAMIT “PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA” PËR VITIN 2023

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.01.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.08 Datë 20.01.2023 Në mbështetje të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 23,24, Ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, neni 73 gërma “d”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, VKM Nr.384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimi Këshillit Bashkiak nr.163 dt.21.12.2022 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2023, 2024, 2025”, shkresës me 13 dt.04.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.144 datë 19.12.2022 Miratimi sistemit të pikëzimit për programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” për vitin 2023; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.383/2 Prot datë 16.01.2023; Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr.383/3 Prot datë 16.01.2023, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës se përfituesve për ato individë/familje që banojnë në Bashkinë Kamëz, dhe që përfitojnë nga programi “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” për vitin 2023, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 *do të përballohen me bashkëfinancim në raportin 70% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe 30% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.*
3. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLLA